



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSCPR-2018

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 29 maj 2018

Gjuha: Anglishte

Emri i dosjes: Dosja e Administrimit Gjyqësor për 2018

Klasifikimi: Rreptësisht konfidencial dhe *Ex Parte*

VENDIM

mbi Kërkesën e Prokurorit për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës sipas nenit 3(8)(a) të Ligjit

Autoriteti kërkues:

Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), pasi ka marrë një kërkesë nga Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës dhe caktimin e një gjykatësi të vetëm, në vijim dhe në përputhje me nenin 3(8)(d) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) merr vendim për vendin e zhvillimit të procedurës në lidhje me caktimin e kërkuar të një gjykatësi të vetëm për shqyrtimin e një kërkesë vijuese për autorizim gjyqësor dhe të të gjitha çështjeve lidhur me të.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 janar 2017 hyri në fuqi *Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës për Vendosjen në Holandë të Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës* (“Marrëveshja me Shtetin Pritës”).
2. Më 29 maj 2018, në përputhje me nenin 3(8)(a) të Ligjit, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar bëri kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në Shtetin Pritës në lidhje me kërkesën e tij për caktimin e një gjykatësi të vetëm për shqyrtimin e një kërkesë vijuese për autorizim gjyqësor dhe të të gjitha çështjeve lidhur me të (“Kërkesa për Ndryshimin e Vendit”).

II. LIGJI I ZBATUESHËM

3. Në nenin 3(6) të Ligjit thuhet se “Dhomat e Specializuara kanë një seli në Kosovë. Siç përcaktohet me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pranues, Dhomat e Specializuara po ashtu kanë seli edhe në shtetin pranues jashtë Kosovës [...]”.
4. Në nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës thuhet se “Institucioni Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur i Kosovës ka një seli në Shtetin Pritës”.

5. Neni 3(8)(a) i Ligjit autorizon Kryetarin e Dhomave të Specializuara, Prokurorin e Specializuar, Mbrojtësit e Specializuar apo Mbrojtësit e Viktimave që, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë ose të sigurisë, sipas gjykimit të tyre, të kërkojnë ndryshimin e vendit të zhvillimit të një gjykimi, të çfarëdo pjese të një gjykimi apo të ndonjë faze apo të fazave të caktuara të procedurës penale sipas Ligjit, në Shtetin Pritës.

6. Në nenin 3(8)(d) të Ligjit thuhet se në rast të një kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në Shtetin Pritës, Kryetari nxjerr një vendim administrativ për ndërrimin e vendit të zhvillimit të procedurës, ose të ndonjë pjese apo faze të saj, në Shtetin Pritës, dhe urdhëron të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

III. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

7. Në përputhje me nenin 3(8)(a) të Ligjit, është kërkuar ndryshimi i vendit lidhur me caktimin e kërkuar të një gjykatësi të vetëm për shqyrtimin e një kërkesë vijuese për autorizim gjyqësor dhe të të gjitha çështjeve lidhur me të.

8. Kryetarja vëren se konsiderata shumë të rëndësishme të sigurisë kërkojnë që vendi i zhvillimit të kësaj procedure të jetë në Shtetin Pritës, për të garantuar zhvillimin efikas, efektiv dhe të sigurt të procedurës.

IV. KLASIFIKIMI I VENDIMIT

9. Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar parashtron se, në përputhje me rregullën 82(1) të Rregullores, Kërkesa për Ndryshimin e Vendit është klasifikuar si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, duke qenë se lidhet me hetimet konfidenciale të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Për të njëjtën arsye, edhe ky vendim mban të njëjtin klasifikim. Si Kërkesa për Ndryshimin e Vendit, edhe ky vendim, mund të riklasifikohen në një datë të mëvonshme, në përputhje me rregullat 82 deri në 84 të

Rregullores, në qoftë se dhe kur arsyet për klasifikimin e tyre aktual pushojnë së qeni të zbatueshme.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA NË VIJIM

CAKTON vendin e zhvillimit të procedurës në lidhje me caktimin e kërkuar të një gjykatësi të vetëm për shqyrtimin e një kërkesë vijuese për autorizim gjyqësor dhe të gjitha çështjeve lidhur me të, në Shtetin Pritës; dhe

KËRKON prej Administratores që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 29 maj 2018

Në Hagë, Holandë.